



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË



Nr. Regj. 903 Them.  
Datë Regj 17.06.2022

Nr.1416/1 Vendimi  
Datë 01.07.2022

**V E N D I M**

**“PËR DEPOZITIMIN E AKTEVE TË ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE ”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

**GJYQTARE    TEUTA    HOXHA**

Në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, sot më date 01.07.2022 mora në shqyrtim aktet si më poshtë:

**KËRKUESE:**

**Klodiana Kapo** e bija e Rushitit, datëlindja 16.04.1981 lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Rr. “Him Kolli” Pall nr.31 Tiranë, në cilësinë e Drjeres Ekzekutive të Qendrës.

**OBJEKTI:**

Regjistrimin e Vendimeve të Bordit Drejtues të Qendrës “FAKTOJE” .

**BAZA LIGJORE:**

Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.  
Ligji nr.8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

Gjykata, si shqyrtoi aktet e çështjes në dhomë këshillimi si dhe praktikën e regjistrimit të kësaj OJF-je;

**V Ë R E N**

Qendra “FAKTOJE” është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 1416 datë 30.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë .

Me datë 28.05.2022 është mbledhur Bordi Drejtues i Qendrës i cili ka marrë disa vendime dhe përkatësisht:

Me vendimin nr.1 datë 28.05.2022 Bordi Drejtues i Qendrës ka vendosur:

- Miratimin e raportit të përgatitur nga Drejtori Ekzekutiv i Qendrës për pasqyrat financiare dhe Raportin e Auditit të qendrës për vitin 2021.
- Shkarkimin nga detyra e Znj. Albana Kasapi nga Bordi Drejtues për shkak se nuk ka marrë pjesë në më shumë se tre mbledhje rresht, bazuar në pikën “f” të nenit 8 të Statutit. Emërimin e zj Estela Koçi , e bija e Astritit ,datëlindja 28.08.1979 si anëtare e Bordit Drejtues
- Ngarkimin e Drejtorit Ekzekutiv për të kryer veprimet për regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin e OJF pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin Nr. 2, datë 28.05.2022 Bordi Drejtues i Qendrës ka vendosur:

- Miratimin e ndryshimeve statutore në Statutin e Qendrës, sipas përmbajtjes së specifikuar në vendim lidhur me nenet 7, 9, 10 dhe 11 të Statutit.
- Ngarkimin e Drejtorit Ekzekutiv për të kryer veprimet për regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin e OJF pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin Nr. 3, datë 28.05.2022 Bordi Drejtues i Qendrës ka vendosur:

- Pranimin e dorëheqjes nga Bordi Drejtues të anëtares së Bordit Drejtues zj. Brunilda Bakshevani ( Milkani).
- Ngarkimin e Drejtorit Ekzekutiv për të kryer veprimet për regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin e OJF pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata vëren se në shqyrtim të kërkesës për depozitimin e akteve të organizatës jofitimprurëse verifikohen kriteret e formës ligjore të akteve të paraqitura dhe legjitimitetit pa i hyrë aspekteve të shqyrtimit në themel dhe elementëve thelbësorë të përmbajtjes së tyre.

Sa më lart, gjykata konstaton se kërkesa dhe aktet janë në pajtim me ligjin dhe në përputhje me statutin si dhe është depozituar brenda afatit 30 ditor të përcaktuara në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në Ligjin nr. 8788, datë 03.05.2001 “ Për organizatat Jofitimprurëse” dhe Ligjin nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” Gjykata,

### **V E N D O S I**

- Pranimin e kërkesës
- Depozitimin e vendimeve të Bordit Drejtues të Qendrës “FAKTOJE” përkatësisht:

Vendimin nr.1 datë 28.05.2022 Bordi Drejtues i Qendrës që ka vendosur:

- Miratimin e raportit të përgatitur nga Drejtori Ekzekutiv i Qendrës për pasqyrat financiare dhe Raportin e Auditit të Qendrës për vitin 2021.

- Shkarkimin nga detyra e Znj. Albana Kasapi nga Bordi Drejtues për shkak se nuk ka marrë pjesë në më shumë se tre mbledhje rresht, bazuar në pikën “f” të nenit 8 të Statutit.
- Emërimin e zj Estela Koçi , e bija e Astritit ,datëlindja 28.08.1979 si anëtare e Bordit Drejtues
- Ngarkimin e Drejtorit Ekzekutiv për të kryer veprimet për regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin e OJF pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimin nr. 2 datë 28.05.2022 Bordi Drejtues i Qendrës që ka vendosur:

- Miratimin e ndryshimeve statutore në Statutin e Qendrës, sipas përmbajtjes së specifikuar në vendim lidhur me nenet 7, 9 ,10 dhe 11 të Statutit.
- Ngarkimin e Drejtorit Ekzekutiv për të kryer veprimet për regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin e OJF pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimin nr. 3 datë 28.05.2022 Bordi Drejtues i Qendrës që ka vendosur:

- Pranimin e dorëheqjes nga Bordi Drejtues të anëtares së Bordit Drejtues zj. Brunilda Bakshevani ( Milkani).
- Ngarkimin e Drejtorit Ekzekutiv për të kryer veprimet për regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin e OJF pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Urdhërimin e Zyrës së Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse për depozitimin e vendimeve sa më sipër dhe kryerjen e shënimeve në skedën e qendrës “Faktoje”

Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të OJF të kryejë veprimet e nevojshme për pasqyrimin e këtij vendimi në regjistrat përkatës.

- **Tiranë më 01.07.2022.**

